




QENDRA DITORE PËR TË MOSHUARIT DHE QENDRA PËR NDIHMË NË KUSHTE SHTËPIE



PËR NE

Në kuadër të Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, që nga shtatori i vitit 2011, është realizuar Projekti kushtuar kujdesit për të moshuarit.

Projekti: "Qendra ditore për të moshuarit dhe Qendra për ndihmë në kushte shtëpie", i mbështetur nga Qyteti i Shkupit dhe Fondacioni Albiz. Projekti po zhvillohet dhe zbatohet me një qëllim kryesor, për zhvillimin e formave të kujdesit jo institucional dhe ofrimin e kujdesit dhe kujdesit shëndetësorë për të moshuarit dhe persona me shëndet të dobët.

Në kuadër të projektit funksionojnë tre qendra ditore për të moshuarit, në DHO Dare Xhambaz, në OKKK Çair dhe në Saraj në Sh.F. "Dituria".

SHËRBIMET DHE AKTIVITETET

- Ushtrime Çikong
- Aktivitetet preventive shëndetsore
- Organizimi i punëtorive të ndryshme krijuese: pikturim, punëtori thurjeje
- Mbështetje administrative
- Punëtori dhe kurse edukative
- Aktivitete dhe Bazare humanitare
- Organizimi i shëtitjeve të përbashkëta (park, muze, teatër, kinema etj.);
- Festimi i aktiviteteve kalendrike të Kryqit të Kuq (*Java e Sëmundjeve Kardiovaskulare, Java e Luftës kundër Tuberkulozit, Java e Kujdesit për të Moshuarit, Dita Botërore e të Moshuarve etj.*);
- Organizimi i lojërave sociale dhe/ose konkurruese (*shah, letra, domino*)
- Diskutime për tema të ndryshme (*libra, filma, situata aktuale*);
- Aktivitete muzikore.

KONTAKT:

071/ 367 - 909 ose 02 / 3228 -347



QENDRA DITORE PËR TË MOSHUARIT DHE QENDRA PËR NDIHMË NË KUSHTE SHTËPIE



Grupi Qëllimor i Projektit, janë personat e moshuar dhe të dobët, që jetojnë vetëm ose me bashkëshortin e tyre, të cilët kanë nevojë për mbështetje mjekësore dhe psiko-sociale në kushtet e shtëpisë dhe të moshuarit aktivë që kanë nevojë për socializim në një program për Plakje Aktive, në konceptin e Qendrës Ditore për të moshuarit.

Objektivat specifike të projektit janë:

Përmirësimi i cilësisë së jetës, shëndetit dhe gjendjes psikofizike e të moshuarve;

Plotësimi i nevojave shëndetësore dhe sociale e të moshuarve;

Socializimi dhe pasurimi i nivelit arsimor e të moshuarve;

Promovimi i Plakjes Aktive dhe një qasje aktive ndaj jetës në pleqëri;

Promovimi i volunterizmit, përfshirja e qytetarëve në punë vullnetare në aktivitete të ndryshme.



Për realizimin e qëllimeve të Projektit të destinuar për të moshuarit që janë target grupi i Projektit, Programi ka zhvilluar një strukturë për veprim dhe funksionim në terren, pra për ofrimin e kujdesit në kushte shtëpie.

Çdo i moshuar vizitohet në shtëpinë e tij nga një Person Mjekësor dhe një Volunter një herë në javë ose sipas nevojave. Në Projekt janë përfshirë 5 Volunterë dhe 5 Persona Mjekësor për nevojat e të moshuarve.

Vizitat nga ana e Personave Mjekësor janë realizuar në zonën e 8 komunave: **Qendër, Kisella Vodë, Karposh, Gjorçe Petrov, Çair, Butel, Shuto Orizari dhe Saraj.**

Shërbimet e ofruara nga Personi Mjekësor në kushte shtëpie janë:

- Matja e sheqerit në gjak
- Matja e presionit
- Kontaktet me mjekun e familjes
- Shpërndarja e barnave falas (të parashikuara në Projekt)
- Dhënia e këshillave për marrjen e terapisë
- Dhënia e këshillave e të ushqyerjes
- Shoqërimi i të moshuarit kur shkon te mjeku

Shërbimet e ofruara nga Volunterët në kushte shtëpie janë:

- Biseda dhe aktivitete të tjera socializuese
- Asistencë gjate të ushqyerit
- Ndihmë në blerjen e produkteve ushqimore, barnave etj.
- Shoqërimi i të moshuarit kur shkon te mjeku, për shëtitje etj.
- Kryerja e punëve administrative për të moshuarit

KONTAKT:

071/ 367 - 909 ose 02 / 3228 -347